

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Vegla Pastrimi

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39224000-8; 42122460-2; 44511120-2;

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.999.100 (dy milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e njëqind) lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari i ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 27, 28 ,29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se vlera limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 599.820 (peseqind e nentëdhjete e nente mije e teteqind e njezet) leke pa tvsh, (20% të vlerës së fondit limit **2.999.100 (dy milion e nentëqind e nentëdhjete e nente mije e njeqind) lekë pa Tvsh.**

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Ofertuesit duhet te paraqesin

a. Çertifikate Personale ISO 9001:2015 ose ekuivalente, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

***Argumentimi :** Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 te VKM 285 date 19.05.2021.Ky certifikim tashme nje standart gjeresisht i kerkuar ne fushen e prokurimeve publike, i mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje levrimin e mallit ne menyre cilesore .*

2.3.3. Deklarate nga Operatori Ekonomik që mer persipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e këkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e percaktuara të AK-ve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesemarres ne daten e hapjes se procedures (date 30.10.2023) nga ora 11:00 deri ne oren 14:00, duhet te paraqese prane AK, mostrat te mallrave objekt prokurimi si me poshte:

Zeri nr.2 - Kacia metalike. Gjeresi 30 cm * Gjatesi 30 cm me bisht druri ose metalike 70 cm



Zeri nr.4 - Lopate transorti me bisht druri. Gjersi 35 cm*Gjersi 35 cm + mbajtesja e bishtit 10 cm *Thellesi 3 cm, me bisht druri 122cm



Zeri nr.7 - Lopata grryerje me bisht druri. Gjersi 24cm *Gjatesi 29 cm + mbajtesja e bishtit 10 cm,me bisht druri 122 cm



Zeri nr.8 - Furçe pastrami me fije metalike me bisht druri.Gjatesi 50 cm*Gjersi 6.5
*Trashesi 2,fije metalike 4 cm, me bisht druri 122cm i inkastruar me perforcime



Zeri nr.13 - Shpatull metalike me bisht druri.Gjersi 9.5 cm*Gjatesi 15.5 cm ,me bisht druri 122cm



3 Zeri nr.24 - Motokorrese me benzine

Zhvendosja 40,2 cm³
Zhvendosja 2,45 cu-in
Performanca 2,1 Um
Fuqia dalëse 2,2 PS
Fuqia e prodhimit 1,6 kW
Pesha 13,4 paund
Pesha 1) 6,1 kg
Gjatësia totale 2) 154 cm
Kapaciteti i rezervuarit të karburantit 21,6 oz
Vëllimi i rezervuarit 0,64 l
Shpejtësia në fuqinë maksimale 9.000 Um



Zeri nr.25 - Fryrese/Thithese gjethesh,me benzine, me thes mbledhes.

Zhvendosja 27,2 cm³

Pesha 1) 5,6 kg

Niveli i presionit të zërit 2) 90 dB(A)

Niveli i presionit të zërit 2) 93 dB(A)

Niveli i fuqisë së zërit 104 dB(A)

Niveli i fuqisë së zërit 106 dB(A)

Niveli i dridhjeve, djathtas 3) 2,5 m/s²

Niveli i dridhjeve, majtas 3) 2,5 m/s²

Qarkullimi i ajrit në regjimin vakum 770 m³/h



Zeri nr.26 - Karroca fshesaresh me tre rrota me kosh.

Permasat e karroces:gjersia 60 cm, gjatesia 120 cm,lartesia 90 cm.

Kontenieri i karroces: diametri 38 cm, lartesia 69 cm,spesori i llamarines 1.5 mm.

Kaseta e karroces:gjatesia 41 cm, gjersia 28 cm, lartesi 21cm,spesori i llamarines 1.5 mm.

Tubi i karroces :diameter 32 cm,spesori I tubit 1.5 mm.

Drezat:plastike

Rrotat e karroces:diametric i rrotave te pasme 25 cm(2 cope fikse pa rrotullim), diametri irrotes se pare 20 cm (me rrotullim 360° me bllokues frenash), goma te mishta, te kene uport te fort metalik.



Operatori Ekonomik ne mementin e dorezimit te mostrave duhet te paraqesi Certificate Origjine dhe Certificate Cilesie sipas Standarteve CE, per te gjithë mostrat e kerkuara.

Argumentim: Kjo kerkese behet per te vertetuar se OE pjesmarres dhe ofertues disponon ne cilesine e duhur dhe te kerkuar te veglave specifike te punes per te cilat AK ka nevoj. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë tabelën si më poshtë me titull Ofertë Teknike. Mosplotësimi me saktësi i ofertës për të gjithë zërat e kërkuar është kusht skualifikues.

Nr.	Pershkrimi i mallit	Kodi origjinal i mallit(kodi origjinal i markes prodhuese te secilit mjet)	Emertimi i katalogut te mallit	Nr i faqes ne katalog
1				
2				
3				
4,etj				

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktorNSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.